



**AKTI THEMELUES**  
**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË**  
**ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**SHKOLLA E LARTË JOPUBLIKE**  
**"LUARASI" (sh.p.k.)**

Unë i nënshkruari Aleks Ilo Luarasi, lindur më 22 mars 1941 në Luaras të Rrethit të Kolonjës dhe banues në Tiranë, Rruga "Brigada e VIII", Pall. 1, Sh. 2, Ap. 14 vendosa themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, sipas kushteve që vijojnë :

**Neni 1**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërin SHKOLLA E LARTË JOPUBLIKE " LUARASI " (sh.p.k.).

Ajo do të jetë shkollë e lartë e nivelit universitar dhe pasuniversitar me një fakultet të vetëm, atë të drejtësisë.

Veprimtaria e saj fillon pas marrjes së lejës nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 2**

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është :

1. Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e shkencave juridike (juristë) me formim të përgjithshëm.
2. Të kryejë studime, kërkime dhe botime në fushën e shkencave juridike.
3. Të kryejë kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurse të specializimit dhe kurse të kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë për juristët.

**Neni 3**

Selia e shoqërisë ndodhet në Rrugën "Myslim Shyri", P 54, Sh 2, Ap 21, Tiranë.

## Neni 4

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ky kapital është nënshkruar tërësisht nga ortaku i vetëm dhe është depozituar në bakë, sikurse vërtetohet nga dokumenti bashkangjitur.

## Neni 5

Afati i veprimtarisë së shoqërisë është mbi 10 vjet.

## Neni 6

Shoqëria është pronë e themeluesit të saj Aleks Ilo Luarasi,

## Neni 7

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë është ortaku i vetëm Aleks Luarasi, i cili ka edhe funksionet e administratorit.

## Neni 8

Autoriteti drejtues i Shkollës së Lartë "Luarasi" është rektori. Autoriteti drejtues i Fakultetit të Drejtësisë është dekani. Rektori dhe dekani emërohen nga ortaku i vetëm dhe administratori i shoqërisë.

Për zhvillimin e veprimtarisë së saj Shkolla e Lartë "Luarasi" krijon organet e veta, si Senati, Këshilli i Fakultetit dhe departamentet, të cilët organizohen dhe veprojnë sipas Statutit dhe Rregullores së saj.

Shoqëria mund të punësojë edhe persona të tjerë të nivelit akademik ose administrativ.

## Neni 9

Shoqëria mbyllet ose riorganizohet me vendim të ortakut të vetëm.


## Neni 10

Në rastin e vdekjes së ortakut të vetëm zbatohen dispozitat e Kodit Civil për trashëgiminë ligjore dhe testamentare.

Tiranë, 2 shtator 2002

ORTAKU I VETËM

Aleks Ilo Luarasi





**STATUT I SHOQËRISË**  
**SHKOLLË E LARTË JOPUBLIKE**  
**“LUARASI” (shpk)**

**Neni 1**

Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi” është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk).

Ajo është shkollë e lartë e nivelit universitar dhe pasuniversitar me një fakultet të vetëm, Fakultetin e Drejtësisë.

Veprimtaria e saj fillon pas marrjes së lejës nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 2**

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është :

1. Të përgatisë specialistë të lartë në fushën e shkencave juridike (juristë) me formim të përgjithshëm.
2. Të kryejë studime, kërkime dhe botime në fushën e shkencave juridike.
3. Të kryejë kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurse të specializimit dhe kurse të kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë për juristët.

**Neni 3**

Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi” është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që i përket një ortaku të vetëm.

Pronari dhe administratori i saj i vetëm është Aleks Ilo Luarasi, lindur në Luaras të rrethit të Kolonjës dhe banues në Rrugën “Brigada e VIII”, Pall. 1. Sh. 2, Ap. 14, Tiranë.

**Neni 4**

Shoqëria Shkolla e Lartë Jopublike “Luarasi” do ta ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat mbi 10 vjet.

## Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ky kapital është nënshkruar tërësisht nga ortakut i vetëm dhe është depozituar në bankë, sikurse vërtetohet nga dokumenti bashkangjitur.

## Neni 6

Selia e shoqërisë është në Rrugën "Myslim Shyri", P 54, Sh. 2, Ap. 21, Tiranë.

## Neni 7

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" është ortakut i vetëm Aleks Luarasi që ka edhe funksionet e administratorit.

Ai gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka asambleja e ortakëve në shoqëritë tregtare sipas legjislacionit shqiptar.

## Neni 8

Autoriteti drejtues i Shkollës së Lartë "Luarasi" është rektori. Autoriteti drejtues i Fakultetit të Drejtësisë është dekani. Rektori dhe dekani emërohen nga ortakut i vetëm dhe administratori i shoqërisë.

Për zhvillimin e veprimtarisë së saj Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" krijon organet e veta, si Senati, Këshilli i Fakultetit dhe departamentet, të cilët organizohen dhe veprojnë sipas Statutit dhe Rregullores së saj.

## Neni 9

Shoqëria mund të punësojë edhe persona të tjerë të nivelit akademik ose administrativ. Marrëdhëniet e punës me këta persona rregullohen nëpërmjet kontratës së punës që lidhet me shkrim ndërmjet palëve.



## Neni 10

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" pasqyrohet në bilancet e saj tremujore dhe vjetore. Ajo mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 11

Të ardhurat e shoqërisë Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" krijohen nga tarifat e studentëve.

Shkolla ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së vet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shuma që mbetet pasi zbriten shpenzimet e përgjithshme dhe të gjitha llojet e detyrimeve përbëjnë fitimin e saj. Fitimi i realizuar disponohet nga ortakut i vetëm.

#### Neni 12

Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" është pronare e pasurisë së saj dhe ka të drejtën e përdorimit e të disponimit të kësaj pasurie në përputhje me qëllimet dhe objektin e veprimtarisë ekonomike.

#### Neni 13

Shoqëria Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" mbyllet ose riorganizohet me vendim të ortakut të vetëm.

#### Neni 14

Në rastin e vdekjes së ortakut të vetëm zbatohen dispozitat e Kodit Civil për trashëgiminë ligjore dhe testamentare.

#### Neni 15

Mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë Shkolla e Lartë Jopublike "Luarasi" dhe personave të tjerë fizikë e juridikë zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Tiranë, 2 shtator 2002

ORTAKU I VETËM

Aleks M. Luarasi

